

Përshëndetje Z. Bala!

Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar elektronikisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në kuadër të Ligjit 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, regjistruar me nr. 206 në regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, pas shqyrtimit të kërkesës, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të ligjit të sipërcituar, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Referuar verifikimit të kryer nga inspektorët që kanë ushtruar kontroll në shoqërinë Kastrati Grup për periudhat e përmendura, rezulton që për secilën pyetje është konkluduar si më poshtë:

1. A disponon DPT certifikatat doganore të zhdoganimit që korrespondon me sasinë e importuar nga subjekti Kastrati Group?
  - -Janë konfirmuar dhe rakorduar të gjitha deklaratat doganore të importit, të paraqitura në sistemin tatimor nga kontrolli në vend. Malli vjen nëpërmjet importit dhe Dogana shqiptare verifikon të drejtën e subjektit për import të këtij produkti, arsyen e përdorimit të tij, dhe clirimin nga regjimi doganor i tij.
  - -Me bilancin material të produkteve, janë konfirmuar dhe rakorduar të gjitha sasitë e karburantit në hyrje dhe dalje.
2. Nëse po, sasia e importuar është gjendje në magazinë apo është hedhur në treg?
  - Sasia e importuar vërtetohet nga dogana, dhe derisa malli të clirohet nga regjimi doganor është nën pergjegjësinë e doganës. Në momentin që malli clirohet nga regjimi dhe shitet sigurisht.
  - -Pyetja që shtrohet është e paqartë, për sa kohë që levizja e produktit kryhet në dinamikë dhe sasia e importuar apo blerë brenda vendit hidhet në treg në varësi të kërkesave.
3. Bazuar në denoncimin, dyshohet se ky karburant është shitur pa faturim, prandaj kërkojmë informacion nga ana juaj, nëse korrespondon sasia në doganë me sasinë e shitur?
  - Nga verifikimet e kryera për periudhat e kontrolluara si dhe bilanci material, nuk ka rezultuar të ketë shitje pa faturë për këtë produkt.
  - Nuk kemi indicje të tilla dhe nga verifikimet në këtë subjekt nuk ka rezultuar që një mall i importuar dhe i cliruar nga regjimi të jetë konkluduar i shitur pa faturë.

Faleminderit për mirëkuptimin.